



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

NR. 7, DATË 29.01.2020

PËR

**RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT AUDIO "RADIO IME", KALIMIN E TË DREJTAVE TË LICENCËS SË SUBJEKTIT PERSON FIZIK ENNO ALIMERKO, PËR TRANSMETIME AUDIO ANALOGE "RADIO IME" TEK SHOQËRIA "RADIO IME" SH.P.K. DHE NDRYSHIMIN E ZONËS SË OFRIMIT TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 19, pika 16, nenit 55, pika 1, gërma c dhe pika 6, nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, rregullores "Për procedurat dhe kriteret e dhënies së licencës së transmetimit audio", miratuar me vendimin e AMA-s, nr. 153, datë 18.07.2016, i ndryshuar, si dhe pas shqyrtimit të aplikimit nr. 1704 prot., datë 30.11.2016 të shoqërisë "Radio Ime" sh.p.k., dhe dokumentacionit plotësues, Autoriteti i Mediave Audiovizive,

VENDOSI:

1. Rinovimin e licencës së subjektit audio privat vendor "Radio Ime", për një periudhë 5 vjeçare.
2. Kalimin e të drejtave të licencës së subjektit person fizik Enno Alimerko, për transmetime audio analoge tek shoqëria "Radio Ime" sh.p.k., me NIPT L81904029Q dhe përfaqësues ligjor Enno Alimerko.
3. Ndryshimin e zonës së ofrimit të shërbimit të subjektit audio privat vendor "Radio Ime" nga "Qyteti Tiranë" në "Bashkitë Tiranë, Vorë, Kamëz, Durrës dhe Shijak", sipas të dhënave teknike, bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Kushtet e licencës së shoqërisë "Radio Ime" sh.p.k., për subjektin audio privat vendor "Radio Ime", mbeten të pandryshuara përveç zonës së ofrimit të shërbimit dhe formës së organizimit të subjektit tregtar.
5. Ngarkohet administrata e AMA-s për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim për pikën 1 i shtrin efektet nga data 09.11.2015, ndërsa për pikat 2 dhe 3 hyn në fuqi menjëherë.

<b>Kryetar:</b>	<b>Gentian</b>	<b>SALA</b>
<b>Zëvendëskryetar:</b>	<b>Sami</b>	<b>NEZAJ</b>
<b>Anëtarë:</b>	<b>Agron</b>	<b>GJEKMARKAJ</b>
	<b>Gledis</b>	<b>GJIPALI</b>
	<b>Suela</b>	<b>MUSTA</b>